NË BESË..!

VLERA E DHJETË DITËVE TË MUAJIT DHULHIXHE

SA SULLTANË E KANË KRYER HAXHIN?

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 21 - Nr. 6 (244), Qershor, 2023

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

“Ky është Libri, që nuk ka dyshim në të!”

(Kur’ani, El-Bekare: 2)

CEREMONI MADHËSHTORE PËR NDER TË HAXHILERËVE SHKODRANË!

110 HAXHILERË NGA SHKODRA U NISËN PËR TË KRYER HAXHIN E SIVJETSHËM...

(f. 18)

KURBAN BAJRAMI, FESTA MADHËSHTORE QË ZGJON SHKODRËN NË LUTJE!

(f. 10)

NË BESË..!

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Një ditë të bukur vere të fillim shekullit tonë, u ktheva nga studimet në Damask. Ma i miri dhe ma i begati vend. Djepi i qytetërimeve, elitave të dijetarëve përgjatë shekujve, farkëtues i mendimit që ndërton dhe qëndron i palëkundur përballë fanatizmit të verbër, kompleksiteteve të panevojshme, devijimeve...

...

Zakonisht në verë, por edhe ndonjë Ramazan, kur kthehesha për pushime të përkohshme, se si më shihnin. E kuptoja mirë arsyen, edhe pse nuk e trazoja veten për ta menduar, qoftë edhe për pak..!? Nuk më bëhej vonë për asgjë dhe asnjeri në këtë nën qiell, sepse besëlidhjen e kisha larg dhe me njerëz të naltë, që nga realitetet tona dhe të institucioneve që kishim asokohe, ata mund të shiheshin vetëm siç shohim sot, shfaqjen e yllit polar, kur arrijmë ta shohim! (Akoma sot, ashtu shihen, në mos edhe më larg se dikur!?)

...

Pastaj u binda të kthehem në vendlindje, edhe pse, gati-gati ndjej përherë e më shpesh një lloj pendese, por që sot, nuk ka më asnjë vlerë...

Pas një letre zyrtare të dërguar nga Medreseja "Haxhi Sheh Shamia" dhe drejtori i saj, z. Hiqmet Bekteshi, ku më paraqitej kërkesa për të dhënë kontributin si mësues, dukej se rrugëtimi im i ri sapo kishte marrë drejtim...

...

Asokohe jepja mësim në Medresenë "Haxhi Sheh Shamia". Kur e kujtoj, plot nëntë vite! Vitet 2001-2010 (e kusur), ishin vite që nuk harrohen, për dinamikën e ngjarjeve dhe situatave, në rrugëtimit e mia, si thirrës islam, si hatib, si mësues medreseje, autor librash, por jo vetëm..!

Në shkollë, më kishin ngarkuar disa lëndë, si: arabishten, besimin, historinë islame, hadithin, predikimin, por jo vetëm. Kuptohet, jo njëherazi dhe me kurbën e klasave që lëvizte nga e gjashta në rritje drejt maturës.

Ishin vite që lanë shenjë në memorie. Për shumë e shumë arsye, personazhe, situata e stacione, për të cilat është herët të flas e të shkruaj (ndonëse shumica e asaj që duhet shkruar është kopsitur mirë e bukur në ditarët përkatës), ato ngelën vite për vitrinë!

Vullnetarisht, me miratim zyrtar të Myftinisë Shkodër, që nga vera e vitit 1998, predikoja të xhumave në xhaminë e Tophanës. Më herët kisha nisur të jepja hytben e xhumasë edhe në disa xhami

të fshatrave, duke filluar me xhaminë e Bërdicës së Sipërme, atë të Mes-Myselimit, Oblikës, por jo vetëm.

Vite dhe kohra të gdhendura në frymë. Personazhe dhe botë për t'u eksploruar, përtej asaj që lexohet në monografinë time me titull: "Rrugëtime të një hatibi", botuar në vitin 2008, me rastin e dhjetë vjetorit të shërbimeve në xhaminë e ndërtuar mbi vakëfin e Shaban efendisë, atë të Hafiz Halilit e që, në verën e vitit 1997 e inauguroi Hafiz Sabri Koçi, në prani të një numri jo fort të madh prej banorëve të lagjes, dikur bajrak i parë i Shkodrës, besimtarëve të moshuar e personelit të Myftinisë Shkodër.

Përse u ula të shkruaj këto rreshta, që mesa shoh, më larguan më shumë se e mendoja në këtë hyrje, plot prekje kujtimesh të ngrira?

Çdo të xhuma, teksa ulesha t'i jap prekjet e fundit hytbes së xhumasë, aty në shtëpinë me qera, në kat të dytë, bri shtëpisë së vjetër të gjyshit tim, në zemër të Parrucës, papritur trokiste dera. Zakonisht nuk më vinte njeri në atë kohë. Zakonisht, nuk dilja nga shtëpia që të enjten pasdite. Të xhumanë, kryeja tre orët (ashtu ishte rregulli i asaj dite për hatibët e xhumasë). Zakonisht...

Në derë, si diell ndriçues, shfaqej një burrë i dritshëm, me syze të mëdha, me dy paterica. Mezi hidhte hapat, e megjithatë, merrte mundim të vinte nga shtëpia e tij, jo larg asaj ku banoja, të ngjitej me shumë mundim e të shfaqej në derë, si paralajmërues se koha për t'u nisur drejt xhamisë së Tophanës po afronte.

Uleshin bashkë për gjysmë ore a më shumë. Çfarë nuk flisnim e çfarë nuk ndanim. Ai, rahmet pastë, ishte shenjë në urtësi, shenjë në burrni e qëndrestari përballë komunistëve dhe torturave çnjerëzore të makinerisë së terrorit që kishte pushtuar vendin në një moment dobësie e në pabesi!

Ai, rahmet pastë, ishte besimtar-eulija! Kur më tregonte se si Resulullahu (alejhis-selam) i kishte ardhur te kryt e shtratit, disa herë pasi kishte përfunduar në koma nga torturat e xhelatëve; fytyra i merrte pamje dielli dhe, nuk i përshkruhej bukuria e buzëqeshjes që merrte fytyra e tij fisnike në ato momente fatlume...

...

Pastaj, bashkë dilnim drejt xhamisë e bashkë ktheheshim... Kështu, derisa një natë, më lajmëruan se zotnia e tij ishte shtrirë për të mos u ngritur më në këtë botë...

...

Atë natë që e lanim trupin e tij pa jetë, bashkë me H. Faik Zaganjorin, ndjeja një dhimbje të madhe, që shoqëruar me dashninë dhe respektin që kisha për zotninë e tij, veçse e madhëronte edhe më shumë në sytë e mi, imazhin dhe portretin e të shtrenjtit, "Gjyshit", Zotni Abdullah Salihi...

...

Sot, sa herë kaloj pranë shtëpisë së tij, ndjej trokitjen e qetë të patericave të tij, që nuk shqetësonin njeri, edhe heshtjen e bënin të ngrihej në këmbë, para rrezatimit të imazhit të tij dhe çfarë përfaqësonte...

Ishte Burrë, prej atyre që na bekon Zoti me shfaqjen e tyre, për të forcuar në Besën e Tij!

Shkodër, më 6 qershor 2023

MESAZH URIMI I MYFTIUT TË SHKODRËS, IMAM MUHAMED B. SYTARI ME RASTIN E KURBAN BAJRAMIT 1444/2023

Arafat, Mekë, 27 qershor 2023

Të dashur vëllezër dhe motra muslimanë,
Të nderuar bashkëqytetarë,

Desht Allahu i Madhëruar që edhe këtë vit të jem në mesin e miliona haxhilerëve nga mbi 180 shtete të botës, me të cilët po ndajmë kënaqësi të papërshkruara, këtu në Mekë, pranë Qabes së Madhnueshme dhe stacioneve të tjera të shenjta të saj.

Sot, që në orët e para të sabahut, u nisëm nga Minaja drejt Arafatit, fushës së besimit dhe adhurimit më të famshme në historinë e njerëzimit. Në këtë vend, ku të dërguar të Allahut dhe besimtarë përgjatë shekujve, janë lutur dhe përgjëruar për mëshirë dhe falje, për begati dhe mirësi, për vete dhe mbarë racën njerëzore.

Të gjithë jemi veshur me të bardha, të gjithë kemi një qëllim, të gjithë mezi presim të nisim lutjet e kësaj dite, nga koha e mesditës dhe deri në aksham.

Bashkë me 110 haxhilerët e Shkodrës dhe mbi 800 nga mbarë Shqipëria, do të lutemi me zemër për të gjithë ju, për familjet, paqen, sigurinë dhe mirëqenien në mesin tonë.

Do të lutemi për forcimin e vlerave të familjes dhe pastrimin e realiteteve të reja shqiptare nga kolonizimet e pamëshirshme, që na shërbehen si oferta dashamire, por që në thelb synojnë të shkatërrojnë tabanin e familjes, moralin, rininë, arsimin, politikën, zhvillimin e vendit, pasuritë e tij, por jo vetëm.

Mesazhet e Kurban Bajramit janë të qarta dhe na ftojnë të kthehemi me zemër nga Zoti Një, Krijuesi i gjithësisë, të mbrojmë dhe të dëshmojmë pa mëdyshje identitetin tonë islam, përkatësinë tonë shpirtërore, vokacionin tonë historik dhe ruajtjen e vlerave të harmonisë kombëtare, pa toleruar cytjen dhe abuzimin e askujt me vlerat dhe krenarinë tonë legjitime.

Ju uroj Kurban Bajramin, me lutjet e atij që beson fort se Rimëkëmbja e vlerave islame, veçse e forcon tabanin tonë kombëtar, e rikthen shoqërinë në ekuilibrat e trashëgimisë së shekujve të lavdishëm, kur shqiptarët drejtonin botën, e mbron nga çdo prekje tinzare, që synon tjetërsimin e mbështetur mbi trillimin dhe falsifikimin e historisë, si dhe e shpëton rininë nga kllapia shumëdimensionale; shpirtërore, intelektuale dhe kulturore, drejt së cilës tërhiqet çdo ditë padrejtësisht!

Allahu ju dashtë dhe ju begatoftë!

Myftiu i Juaj

Imam Muhamed B. Sytari

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

"Shumë e rëndësishme është t'i mësojmë fëmijët tanë me edukatën e namazit dhe kënaqësinë e frekuentimit të xhamive tona. Është shërbimi më i mirë që u bëjmë dhe investimi më thelbësor për të dy jetët!
Fëmija i edukuar me namaz, është njeri i disiplinuar me kohën, me njeriun, me llogaritë e përditshme, me jetën! Është individ i fortë, i sigurtë, ndërtues, i hapur në komunikim, i paqtë dhe i pastër!"

Xhahid Bushati, *shkrimtar*

DOSJA NR. 4921 MA SOLLI "TË GJALLË" GJYSHIN TIM HAFIZ HALIT "RASHIT" BEG IBRAHIM BEG BUSHATIN

-Në kujtim, me rastin e 168-vjetorit të lindjes së gjyshit tim të nderuar Hafiz Halit Bushati (14 qershor 1855 -28 ramazan 1271- 27 dhjetor 1916)

Panairi i 23-të i librit në Prishtinë u hap me dt. 06.06. 2023 dhe ditën e tij të fundit e kishte me dt. 11.06.2023. Ditët e këtij Panairi, nga pikëpamja formale janë vetëm konvencionale (simbolike), se jehoha e Panairit vazhdon dhe libri me diturinë që mbart brenda kapakëve të tij, udhëton e udhëton... duke u bërë edhe më i ditur në duart e lexuesve.

Kësaj herë në Panair, së bashku me mikun tim, librarin Arian shkuam në ditën e dytë. Ky është një ritual i domosdoshëm për mua, i vlefshëm dhe mbresëlënës, që e bëj çdo vit. Dhe u bënë shumë vite, sa nganjëherë dhe ngatërrohem... Për ta "korrigjuar" vetveten, nxjerrë bllokun e shënimeve. Çdo vit, Panairi i librit në Prishtinë, ka faqen apo më shumë faqe, ku janë hedhur me kujdes shënimet e mia në bllokun tim që i ngjan sa udhërrëfyesit aq dhe dijetarit.

Edhe ky Panair, si çdo panair i mëparshëm më ofron kujtime, biseda, pika loti për shkrimtarët e letërsisë shqipe që kanë ndërruar jetë, takime dhe informacione librore që me dëshirë e vullnetmirë më jepnin punonjësit e stendave të Shtëpive Botuese..., etj., etj. Pra, edhe ky Panair në portretin dhe konfiguracionin e tij nuk ishte i ndryshëm nga të mëparshmit, vetëm me një ndryshim: ardhja e librave të rinj me zërin shqip në gjini e zhanre të ndryshme është gjithnjë e më e pasur. Dhe unë jam i interesuar, kryesisht, në botimet e letërsisë shqipe për fëmijë që botohet në Kosovë.

Udhëtoj dhe eci ngadalë nga njëra stendë në tjetrën. Diku bëj pyetje, diku buzëqesh, dikush më njeh e dikush më kujton... Dhe nisin: shmalljet, përqafimet dhe bisedat rreth librave e krijimtarisë... Takoj shkrimtaren e talentuar Dritë Ruhani, takoj miqtë e vjetër si vëllezër Skënder Zogaj, Xhevat Syla, Ibrahim Kadriu, Sabit Jaha. Takoj, gjithashtu, Vjollcën fisnike, të shoqen e poetit të talentuar që nuk jeton më Shkëlzen Zalli; djalin e mikut tim shkrimtar të brezit të parë të letërsisë në Kosovë, që shumë kërkova ta njoh e nuk e njoha, Shpend Hoxhën. Kërkova me sy e më shpirt se mos i "takoj" shkrimtarët: Rifat Kukaj, Arif Demolli, Gani Xhafolli, Hasan Hasani, Abdullah Thaçi... I takoj, se aty janë... Shndrisin si yje dhe me një kaltërsi qiellore...

Përsëri udhëtoj dhe eci ngadalë nga njëra stendë në tjetrën... Kam dhe një kujtesë e porosi nga miku im i çmuar Muhamed Sytari, se në Sh. B. "Dituria Islame" më duhet të blej librin: "Dijetarë shqiptarë në Perandorinë Osmane" (1880 - 1912) - Sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Osman - të studiuesve

të nderuar dhe të respektuar Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmedi, Ramadan Shkodra, Botim i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, Sh. B. "Dituria Islame", Prishtinë, 2021.

Libri është një botim luksoz, që shndrit dhe rrezaton si ar, dhe është ëndërr për çdo krijues ta ketë një botim të tillë për veprën e vet! E marr në duar si një pasuri e rrallë dhe e shtrenjtë. E shikoj, e rishikoj, e hap, e shfletoj... Fillimisht po njihesha me përmbajtjen e librit. Autorët e kishin konceptuar librin duke u dhënë "frymë e jetë" Dijetarëve shqiptarë sipas qyteteve e vendlindjeve. Nga faqja 407 deri në faqen 433 ishte: SHKODRA. Çdo jetë e shkruar shoqërohej me faksimilen origjinale e shkruar në gjuhën, shpresoj, në gjuhën osmane.

Në këtë kapitull flitej për dijetarët shkodranë, si: ***ABDULLAH EF. MYFTIU - TABAKU*** *(SHKODRA)*, ***ABDURRHAMAN EF. Begu*** *(SHKODRA)*, ***ADEM EF. - SALIH EF. MYFTIU (SHKODRA), HAFIZ HASAN EF. LOHAJ (SHKODRA), JUSUF EF. HAFIZ HYSENI (SHKODRA), MEHMET EF. HAXHI OSMAN EFENDIZADE (SHKODRA), TAHIR EF. MYFTIU*** *(SHKODRA)*, DHE... NË FAQEN 420... ISHTE I SHËNUAR DHE EMRI I GJYSHIT TIM ***HAFIZ HALIT EF. BEG BUSHATI*** *(SHKODRA)*.

E papritur për mua!? E gjithë qenia ime rendte drejt viteve të panjohura dhe të humbura... Vërtet të humbura? Jo. Dikush i kishte ruajtur dhe tre studiues shqiptarë i kishin zbuluar në



arkivat e heshtura e të largëta... Po pse kështu të ndodhë?! Çfarë të them më shumë... Më lejoni të përulem me respekt! "Gjyshi im!" - më foli një zë i brendshëm shpirti. Gjyshi im!.. Sa më kanë munguar kujtimet për Ty!.. Sa më ka munguar fjala e sigurt për Ty! Fjala, që thotë gjithnjë të vërtetën, se kush je, o Halit Bushati? Në këtë libër të vyer më erdhe "I GJALLË!"... E besoja dhe nuk e besoja... Por ishte e vërtetë: - Ti, ishe aty, në heshtjen e fisnikërinë tënde! Bëra pak mënjanë. Shikoja ato faqe, ku njerëzorja dhe hyjnorja rrinin sëbashku... Vështroja ato rreshta jete të shkruara, portretin e tij, që më thonte: "... më në fund të njoha!" - dhe qaja, qaja pafund... Kujdesesha që lotët e mi të mos lagnin portretin e Gjyshit tim të shtrenjtë!

Nuk e di sa herë i lexova ato rreshta. Nuk e di... Doja të pushonin në shpirtin tim!

Mësova ditën e lindjes dhe të vdekjes së saktë e të plotë të gjyshit tim. Mësova se, cili ishte dimensioni i autoritetit të tij. Mësova sesi quhej baba i gjyshit tim. Për shkollat që kishte mbaruar, për ixhazetin që ia kishte dhënë Dijetari Hasan ef. Podgorica. Mësova se edhe ti, i dashur gjysh ke dhënë ixhazet e ke nxjerrë diplomantë. Mësova se Ti dije këto gjuhë: Shqipe, Arabe, Turke dhe Perse. Mësova se kishe qenë mësues. (Gjyshi im, mësues ishte djali yt Hysniu. Mësues në Medrezenë e përgjithshme të Tiranës e më pas të Shkodrës. Mësues ka qenë dhe nipi i madh i yti, Haliti që trashëgoi dhe nderoi emrin tënd. Edhe nipi i dytë, që isha unë. Një pjesë të jetës sime e bëra si mësues në Medrezenë "Haxhi Sheh Shamia".

Nuk e di me këtë copëz jete prej mësuesi, sa ia kam arritur të plotësoj misionit tënd e të babës Hysni. Mësues qe dhe daja im i dytë, Agimi. Pra, ishim në periudha të ndryshme kohe mësimdhënës e dritëdhënës, por Profesori ishe Ti. Mësova se në momente të caktuara duhet të dish të japësh edhe dorëheqjen, dhe ti e bëre dy herë. Qëndrin korrekt, i dinjitetshëm dhe vështrimlargët. Mësova se kishe qenë dhe bamirës. Mësova se kishe qenë dhe me detyrën e sekretarit të Zyrës së Fetvasë në Myftininë e Shkodrës. Pra, krijove profilin tënd prej juristi të dëshmuar e specialisti të jurisprudencës islame. Mësova se kishe qenë kaligraf dhe kopjues i dorëshkrimeve në gjuhën arabe dhe osmane. Mësova se je njohur edhe si "Lito Begu", dhe je konsideruar si një nga personalitetet më të shquara të elitës intelektuale shkodrane nga gjysma e dytë e shek. XIX deri në vitet '20 të shekullit të kaluar.

Mësova se në vitet e fundit të jetës Ti bëje të njëjtën rrugë: Xhami e Kuqe (Perash) - Bibliotekë (që ishte e pasur në libra); Bibliotekë - Xhami e Kuqe. Jetë dijetarësh!

Mësova se dosja nr. 4921, me ndihmën e fisnikërinë e studiuesve të ditur Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmedi, Ramadan Shkodra, më sollën "të gjallë" gjyshin tim Hafiz Halit Bushati. Thonë se Dijetarit nuk i humbet as emri, as dija, as rruga.

Shkodër, më, 13.06.2023

FRAGMENTE NGA PËRCJELLJA E HAXHILERËVE SHKODRANË NË FILLIM SHEKULLIN 20

Paraditën e së enjtes, më 1/6/2023, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, pranoi dhuratën e arkivit personal të prof. Muamer Vuci, koleksionin prej 18 fotosh të vjetra që kanë fiksuar fragmente të spikatura nga përcjellja e haxhilerëve shkodranë në fillimet e shekullit 20.

Myftiu e falënderoi zotërinë e tij, mësuesin veteran dhe intelektualin e mirënjohur, z. Muamer Vuci, njëherazi edhe kryetar i Shoqatës së Miqësisë Shqipëri – Vendet Arabe, për këtë dhuratë të çmuar që i shtohet arkivit të Myftinisë Shkodër dhe që do të përdoret për ekspozim me rastin e aktiviteteve të përvitshme që Myftinia Shkodër organizon me rastin e trajnimit dhe përcjelljes së haxhilerëve të qytetit të Shkodrës.

Gjatë takimit të përzemërt u diskutua rreth traditës së vjetër shkodrane të përcjelljes së haxhilerëve dhe u ra dakord që të punohet për ngritjen e një memoriali në përkujtim të kësaj tradite si dhe emërtimin e një rruge në nder të haxhilerëve shkodranë ndër shekuj.

SA SULLTANË E KANË KRYER HAXHIN?

Hazir D. Selmani, *Gostivar*

Përgjigja e thjeshtë është se shumë pakëz edhe atë për një arsye të vetme, e që ishte se shumicës prej tyre u mungonte një ose dy kushte të haxhit, e që janë siguria gjatë udhës si dhe mosqenia në haps (burgim). Këtë do ta shohim në vijim.

Së pari, numri i sulltanëve të Perandorisë Osmane mund të llogaritet 36. Prej tyre, vetëm dy llogariten se e kanë bërë haxhin me vetëpjesëmarrje të tyre. I treti, derisa bëhej gati për marrje të udhës së haxhit u vra. Ndërsa i katërti edhe pse shkoi në Mekë, ai u pengua nga sëmundja dhe kreu vetëm umran me vetëpjesëmarrje, ndërsa haxhin e bëri me përfaqësim duke dërguar dikë tjetër ta kryejë atë në vend të tij, siç e patën bërë edhe shumica e sulltanëve tjerë.

Këta 4 janë: Bajaziti II, i cili në haxh shkoi në vitin 886 hixhri (1481) dhe u kthye një vit më vonë. Sulltan Osmani II, i cili u vra gjersa bëhej gati për t'u nisur në haxh edhe atë në vitin 1031 hixhri (1622). Sulltan Abdulhamidi II, për të cilin thuhet se në vitin 1326 hixhri (1908) e ka kryer haxhin, mirëpo skajshmërisht fshehurazi dhe me dukje që nuk njihej dot. Si dhe sulltan Muhamed Vahidudin VI në vitin 1341 hixhri (1922) u nis për haxh dhe pasi e bëri umran u sëmurë.

Tani nëse do t'i llogarisnim vetëm 2 që e kanë kryer haxhin me vetëpjesëmarrje të tyre, kjo gjë në gjuhën matematikore na del 5.56% e 36 sulltanëve. Ndërsa nëse do të thonim 4, atëherë i bie 11.11% e 36 shulltanëve. Pra, shumica absolute e tyre atë e kanë bërë me përfaqësime, duke dërguar dikë tjetër ta kryejë haxhin në vend të tyre, madje disa sulltanë patën dërguar deri në njëqind veta në vend të tyre, e disa të tjerë dërgonin dijetarë të mëdhenj në vend të tyre.

Së dyti, përse pati ndodhur kështu?

Me haxhin kanë të bëjnë disa kushte (farze) që ndahen në katër grupe (A, B, C dhe D). Kushtet janë marrë nga Sherhu'l-Lubab dhe Raddu'l-Muhtar:

A. Kushtet që haxhi të të bëhet farz ose shurutu'l-vuxhub. Kush i plotëson këta kushte, ai e ka farz haxhin. Në këtë grup janë 7 farze:

1. Të qenurit mysliman,
2. Të diturit se haxhi është obligim,
3. Të qenurit në moshën bylyk,
4. Të qenurit mendërisht i shëndoshë,
5. Të qenurit në status të lire, pra joskllav,
6. Mundësia (kapaciteti ekonomik) për kryerje të haxhit.
7. Vakti i haxhit.

B. Kushtet që ta obligojnë çuarjen në



vend të haxhit, i cili të është bërë obligim ose shurutu'l-eda. Kush i plotëson këta kushte me kushtet e grupit të parë, ai e ka farz haxhin plus e ka farz që atë ta kryej me vetëpjesëmarrje. Ndërsa, nëse i mungon një kusht prej këtyre të grupit të dytë duke i plotësuar gjitha kushtet e grupit të parë, këtij nuk i bëhet obligim që atë ta kryej me vetëpjesëmarrje, porse mundet edhe me dërgim të dikujt tjetër në vend të tij dhe nëse nuk e bën këtë të parën atëherë e ka obligim lënien e vasijetit për haxh pas vdekjes së tij. Në këtë grup janë 5 farze:

1. Shëndeti trupor nga sëmundjet,
2. Siguria e udhës si për trupin ashtu edhe për pasurinë.
3. Mosqenia në haps (burgim).
4. Mahremi besnik (kjo vlen vetëm për gratë).
5. Mosqenia në idet (idet është afati kohor ku fetarisht femra pas vdekjes së bashkëshortit ose shkurorëzimit, nuk ka të drejtë të lidhë kurorë tjetër dhe ky shart vlen vetëm për gratë).

C. Kushtet që duhen plotësuar, që haxhi i çuar në vend, të jetë korrekt (sahih) ose shurutu sihati'l-eda. Në këtë grup janë 9 farze, ku nëse humbet njëri nga këta, atëherë haxhi nuk është sahih:

1. Islami,
2. Ihrami,
3. Vakti,
4. Vendi,
5. Temjizi (pjekuri mendore e të voglit që bën ndarjen dhe dallimin nga gjërat që duhen bërë dhe gjërave që nuk duhen bërë. Për këtë kusht ka ca përjashtime ku vlen përfaqësimi).
6. Vetëdija mendore (edhe për këtë kusht ka ca përjashtime ku vlen përfaqësimi).
7. Çuarja në vend e riteve (sharte, rukne dhe vaxhibe) të bëhet me vetëpjesëmarrje përveç kur ka arsye për disa pjesë të haxhit.
8. Mos akti intim pas ihramit.
9. Çuarja ne vend e haxhit po në atë vit që hyhet në ihram.

D. Kushtet që duhen plotësuar që haxhi i çuar në vend korrekt, të shkojë për larje të haxhit farz ose shartu vukuihi ani'l-fard. Edhe në këtë grup janë 9 farze, ku nëse humbet të paktën njëri, atëherë haxhi i obliguar që është duke u çuar në vend me vetëpjesëmarrje nuk llogaritet larje e haxhit obligativ. Këta farze janë:

1. Islami,
2. Qëndrimi në islam deri në vdekje,
3. Mendja,
4. Liria,
5. Bylyku,
6. Çuarja në vend me vetëpjesëmarrje, kuptohet po të mundet,
7. Mosnijetimi i haxhit nafile,
8. Mosprishja e haxhit si dhe
9. Mosnijetimi i haxhit për dikë tjetër.

Këta sharte kanë shumë shpjegime, e që shkrimi nuk ka këtë qëllim. Por ajo që na intereson është se në kushtet e "Gurpit B" ishin edhe siguria e udhës si dhe mosqenia në haps (burgim). Siguria e udhës për ato periudha kohore nuk kërkon shumë sqarime, e sidomos për sulltanët ngase ata mund të sulmoheshin në çdo kohë dhe vend shto edhe faktin se udha e haxhit prej Stambolli shkuarje-vajtje merrte 4-8 muaj kohë. E një shtet i sulmuar nga brenda dhe jashtë të qëndrojë deri 8 muaj pa sulltan ishte rrezik i madh.

Fakihu dhe muhadithi i madh hanefi, mulla Ali Lexuesi në veprën e tij "Sherhu'l-Lubab", gjersa komenton shartin e mosqenies në haps shton edhe këtë: "Transmetohet nga Shemsu'l-islami se sulltani dhe ata princër që janë sikurse ai me pozitë të rëndësishme bashkangjiten me personin që është në haps për sa i përket hukmit. Këtyre u bëhet obligim haxhi nga malli i tyre. D.m.th. nëse kanë mall të pa zhytur në haqet e njerëzve... Kështu, ngase këta kurdo që dalin nga mbretëria ndodhin shkatërrime në trojet e tyre si dhe fitne mes popullatës, madje ndoshta edhe vetë ai mund të vritet në kësi situatash. Njashtu atë mund ta pengojë edhe ndonjë mbret tjetër nga hyrja në kufinjtë e tij dhe kështu vjen fitne e madhe që shpie në dëm të madh për mbarë myslimanët si në jetën e tyre ashtu edhe në fenë e tyre.

Me aq sa duket, kjo vlen për atë person që sulltanatin e tij e ka të ngritur me plotësimin e sharteve fetare, në të kundërtën i bëhet obligim vetëshkarkimi dhe ngritja në pozitë e atij halifit meritor, kuptohet nëse kjo nuk shpie në shpartallim të ushtrisë së tij." El-Mesleku'l-mutekasit fi'l-Menseki'l-Mutevesit (Sherhu'l-Lubab). Mekë: Metbeatu't-Terakij el-Maxhidijeh, botimi i parë, 1910. Fq. 16. Kjo gjë aprovohet edhe nga Ibën Abidini në të dy hashijet e tija "Radu'l-Muhtar" dhe "Minhatu'l-Halik".

Edhe diçka për në fund, sipas përllogaritjeve të studiuesit H. Sherif (të cilat nuk kam mundur t'i kontrollojë vetë) del kjo e dhënë për sulltanët dhe mbretërit se, prej emevitëve të Shamit vetëm 5 prej tyre e patën kryer haxhin me vetëpjesëmarrje. Prej emevitëve të Andaluzisë asnjë. Prej abasidëve të parë 3, ndërsa prej të dytëve asnjë. Si dhe prej ejubitëve asnjë, madje as vetë Salahudini. Shkaqet u përmendëm më lartë.

P.s. kjo assesi nuk është nxitje për moskryerje të haxhit. Por është sqarim i një të dhëne historike të një kohe të vështirë dhe shkaqet që çuan deri te ajo.

Burimet:

1. Sherhu'l-Lubab (El-Mesleku'l-mutekasit fi'l-Menseki'l-Mutevesit).
2. Raddu'l-Muhtar (Hashijetu Ibën Abidin).
3. Minhatu'l-Halik.
4. El-Nijabetu bi'l-haxhi ani's-selati el-uthmanijin, etj.

CILA ËSHTË MË E MIRË, BLERJA E KURBANIT DHE THERJA E TIJ APO SHPËRNDARJA E VLERËS SË TIJ PËR FUKARENJTË?

Përgjigja e Shejkhul-Ez'her, Dr. Ahmed Et-Tajjib,

Pyetje: Cila është më e mirë, blerja e kurbanit dhe therja e tij apo shpërndarja e vlerës së tij për fukarenjtë?

Përgjigjet Shejkhul-Ez'her: Fillimisht, kjo pyetje, që është përhapur kohëve të fundit, është si thënia e disa njerëzve: Lëreni rrotullimin (tavafin) rreth Qabes dhe silluni rrotull fukarenjve!

Apo, thënia e disa të tjerëve: Të japësh sadaka vlerën e kurbanit është më e mirë se therja e tij!!

Ose, thënia e dikujt tjetër: Një kafshatë në gojën e të uriturit është më e mirë se ndërtimi i njëmijë xhamive!

Për t'ju përgjigjur këtyre pyetjeve të fryra, themi me ndihmën e Allahut:

- Së pari: Këto fjalë, pa marrë parasysh, se a e di apo nuk e di, qëllimi i tyre është zhvlerësimi i myslimanëve në dispozitat e dukshme, përmes të cilave shfaqen dispozitat e tjera islame dhe përmes tyre dallohet nga të tjerët;

Ose, ata, të cilët i thonë këto fjalë, nuk e njohin të vërtetën e fesë, dispozitat e urta të saj dhe renditjen e gjërave parësore.

Fukarenjtë kanë ekzistuar në çdo kohë, që nga koha e Pejgamberit (a.s), e deri në kohën tonë sot, dhe askush nuk e ka thënë një fjalë të tillë të ftohtë.

- E dyta: Pjesa më e madhe, e atyre që bëjnë Umre të shumta, të cilëve Allahu u ka dhënë pasuri, njihen gjithashtu edhe për sadakatë (lëmoshat) dhe kontributet e tyre; sepse në shumicën e rasteve, nuk i kushtojnë rëndësi Umres, duke e kryer disa herë, përveçse ata, të cilët e kanë zemrën të mbushur me besim.

- E treta: Përse nuk janë krahasimet, veçse mes Umres, kurbaneve, dispozitave islame, ndërtimit të xhamive dhe mes fukarenjve?!

Përse nuk thuhet: Mos blini mish dy herë në javë, blini një herë në muaj dhe silluni rrotull fukarenjve!

Përse nuk thuhet: Mos e pini cigaren (duhanin), dhe paret e tij, jepjani fukarenjve!

Përse nuk thuhet: Lërini gëzimet familjare nëpër restorante luksoze dhe shpenzimet marramendëse, dhe silluni rreth fukarenjve!

Përse i shpenzoni paratë në luks, në muzikë, në filma, në seriale, në ndeshje futbolli, në internet... dhe të mos sillet tërë kjo pasuri rreth fukarenjve!

Përse!! Dhe përse!!

Pyetja e jonë tani, është se përse nuk na lini me dispozitat tona, që të kënaqemi me to?

Përse krahasoni mes dy adhurimeve, që të dyja kanë mirësitë e tyre, sikur u dëshirohet njerëzve të lënë çdo gjë dhe të interesohen, vetëm për një adhurim të vetëm!!

Këto pyetje përpunohen natën prej atyre, që i thurin kurthe kësaj feje, pastaj u shfaqen ditën myslimanëve, i marrin mendjelehtët prej tyre dhe ata, të cilët mashtrohen me anën e jashtme të shprehjeve dhe delikatesën e tyre, e nuk e dinë se çfarë ka pas tyre prej faktorëve të shkatërrimit të dispozitave islame, të dukshme dhe të padukshme. Pastaj, pjesa më e madhe e atyre, të cilët i qarkullojnë këto shprehje, në shumicën e rasteve nuk sillen (nuk bëjnë tavaf) rreth Qabes, e as rreth fukarenjve!!

Me një fjalë, përgjigjja ndaj pyetjes është se: Kurbanet janë më të mirë dhe qëndroi kësaj gjëje dhe mos i kushto vëmendje këtyre pretendimeve, që kërkojnë të mohojnë dispozitat e myslimanëve dhe fshirjen e tyre nga ekzistenca.

Nëse ther kurban dhe je i kujdesshëm ndaj fukarenjve deri në këtë mas, atëherë shpërndaje tërë kurbanin apo edhe më shumë se një kurban, ndaj fukarenjve; ose jepe pasurinë tënde për fukarenjtë dhe të varfrit... e na i lër ne kurbanet tonë.

E, nëse refuzon dhe, edhe mendja jote e refuzon, përveçse të na largosh nga dispozitat tona, atëherë më mirë hesht. Allahu është Ndihmësi ynë!

Allahu i Madhëruar thotë: "Kush i madhëron dispozitat e Allahut, atëherë kjo është prej përkushtimit të zemrave!" – (Kur'ani, El-Haxh: 32)

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

VLERA E DHJETË DITËVE TË MUAJIT DHULHIXHE

Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Allahu (xh.sh) si mirësi ndaj besimtarëve, ka caktuar ditë dhe kohë në të cilat ibadeti ka shpërblim shumë më të madh se sa në ditët e tjera. Një prej këtyre mirësive janë edhe dhjetë ditët e para të dhulhixhes.

1. Muaji i dhulhixhes është muaji i dymbëdhjetë i kalendarit hënor dhe është një prej muajve të shenjtë. (Muajt e shenjtë në Islam janë: Muharrem, Rexheb, Dhulkade dhe Dhulhixhe).

2. Allahu i Madhëruar është betuar në këto dhjetë ditë: "Pasha agimin! Pasha dhjetë netët!"[1]

Ibn Abasi (r.a) thotë: "Dhjetë netët e përmendura në këtë ajet kanë për qëllim dhjetë ditët e dhulhixhes. Ky është mendimi që mbështesin shumica e komentuesve të Kuranit.[2]

3. Nuk ka vepër më të mirë dhe më të dashur tek Allahu (xh.sh) sesa ajo vepër që realizohet në këto dhjetë ditë. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Nuk ka vepra me të mira tek Allahu në shpërblim, se sa veprat që kryhen në këto ditë". I thanë: E as xhihadi në rrugë të Allahut? Tha: "As xhihadi në rrugë të Allahut, vetëm nëse njeriu del në xhihad me trupin e tij dhe me pasurinë e tij dhe nuk kthehet prej saj me asgjë (vdes shehid)!"[3]

4. Në këtë muaj është dita më e madhnueshme tek Allahu (xh.sh). Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Dita më e madhnueshme tek Allahu është dita e Kurban Bajramit (kjo është ditë feste për muslimanët) dhe ajo që vjen pas saj.[4]

5. Në këtë muaj gjendet dita e Arafatit. Ebu Hurejra (r.a) transmeton se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Allahu i Madhëruar krenohet para melekëve të Tij në Ditën e Arafatit me haxhilerët që qëndrojnë në Arafat dhe u thotë melekëve: Shikoni robërit e Mi se si kanë ardhur tek Unë të lodhur e të pluhurosur; më janë përgjigjur Mua pasi i kam thirrur ata".[5]

Dijetarët thonë: Mburrja e Allahut para melekëve me haxhilerët, nënkupton se ata janë të falur nga gjynahet se Allahu nuk mburret me gjynahqarët. Ai mburret me robërit e tij vetëm pasi të pendohen dhe t'u falen gjynahet.[6]

Agjërimi i kësaj dite i shlyen gjynahet e dy viteve. I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: "Agjërimi i ditës së Arafatit i shlyen gjynahet e vitit të kaluar dhe vitit të ardhshëm!"[7]

Qëllimi me këtë falje është falja e gjynaheve të vogla, falja e të cilave kushtëzohet me braktisjen e gjynaheve të mëdha, siç thotë Allahu (xh.sh): "Në qoftë se ju u shmangeni gjynaheve të mëdha, që ju janë ndaluar, Ne do t'jua falim gabimet tuaja të vogla".[8]

Ibn Kajjimi (Allahu e mëshiroftë) thotë: Përse agjërimi i ditës së Arafatit i shlyen gjynahet e dy viteve ndërsa agjërimi i ditës së Ashures i shlyen vetëm gjynahet e vitit të kaluar? Për dy arsye:

1. Dita e Arafatit është në muajt e shenjtë dhe Allahu është betuar për këtë ditë. Kjo e bën madhështore agjërimin e kësaj dite.

2. Vlera e agjërimit të kësaj dite është vetëm në Islam. Kurse agjërimi i ditës së Ashures ka qenë edhe tek popujt e mëhershëm. Agjërimi i kësaj dite është i pëlqyeshëm për ato njerëz që nuk janë në Haxh. Ibn Kajjimi (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: Dita e Arafatit është festë për ata që janë në Arafat kështu që nuk është e pëlqyer për ta agjërimi i kësaj dite.[9]

Tregohet se është pyetur Sufjan ibn Ujejne (Allahu e mëshiroftë) për arsyen e ndalimit të agjërimit të kësaj dite për haxhilerët dhe ai ka thënë: Ata janë vizitorët dhe mysafirët e Allahut; kështu që nuk është e drejtë për Fisnikun t'i mbajë të uritur mysafirët e Tij![10]

Shtimi i lutjeve në këtë ditë. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Lutja më e mirë është lutja që bëhet ditën e Arafatit. Dhe fjala më e mirë që e kam thënë unë dhe Pejgamberët para meje është: "Askush nuk meriton të adhurohet me të drejtë, përveç Allahut, të Vetëm e të pashoq. Ai është zotëruesi i gjithçkaje në qiej e tokë, vetëm Atij i përket falënderimi ynë, Ai është i Plotfuqishëm mbi gjithçka".[11]

1. Kur'ani, El-Fexhr: 1-2.
2. Tefsir İbn Kethir, 8/390; Ibn Rexhebi në "Letaif el-Mearif", 268.
3. Transmetuar nga Buhariu.
4. Transmetuar nga Imam Ahmedi dhe Hakimi.
5. Transmetuar nga Ibn Huzejme dhe Hakimi. Hakimi ka thënë: "Hadithi është i vërtetë sipas kushteve të Buhariut e Muslimit, edhe pse ata të dy nuk e kanë transmetuar.
6. Et-Temhid, Ibn Abdulber, 1/120.
7. Transmetuar nga Muslimi.
8. Kur'ani, En-Nisa: 31.
9. Zadu'l Mead, 1/61.
10. Ibn Rexhebi në "Letaif el-Mearif".
11. Transmetuar nga Tirmidhiu.

Abdullah ibn Mubarek ka thënë: Në ditën e Arafatit shkova tek Sufjan Eth-Thevri dhe e pashë të gjunjëzuar duke qarë. E pyeta kush është më i dëshpëruari prej haxhilerëve në këtë ditë? Ai m'u përgjigj: "Më i dëshpëruari prej haxhilerëve është ai, që mendon se Allahu nuk ia falë gjynahet në këtë ditë".[12] Prandaj t'i shtojmë lutjet dhe t'i kërkojmë falje Allahut sa më shumë në këtë ditë.

Në ditën e Arafatit u përsos feja Islame dhe u plotësua dhuntia e Allahut ndaj muslimanëve. Tregohet se një hebre (çifut) e ka pyetur Omerin (r.a): "O prijës i besimtarëve! Ju keni një ajet në Librin tuaj që ju e lexoni, po të na zbriste ne çifutëve një ajet i tillë do ta kishim shpallur ditën e zbritjes së tij ditë feste. Omeri e pyeti: Cili është ai ajet? Hebreu i tha: "Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj."[13]

Atëherë Omeri (r.a) i tha: "Ne e dimë kohën dhe vendin ku ka zbritur ky ajet. Kur u shpall ky ajet, Pejgamberi (a.s) ndodhej në Arafat dhe ishte ditë e xhuma."[14] E këto ditë janë dy festa për ne".

6. Në këtë muaj besimtari shpreh falënderimin ndaj Zotit dhe mëshirën e Tij ndaj të varfërve me prerjen e kurbanit. Allahu (xh.sh) thotë: "Falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!"[15]

7. Në këto dhjetë ditë bashkohen të gjitha adhurimet. (Me shpirt, me turp dhe me pasuri). "Dhjetë ditët e dhulhixhes janë të veçanta nga ditët e tjera, sepse në këto dhjetë ditë bashkohen të gjitha llojet e ibadeteve si: namazi, agjërimi, lëmosha, haxhi, kurbani etj".[16]

Si ti kalojmë këto dhjetë ditë?

1. Të bëjmë sa më shumë dhikër.

2. T'i agjërojmë këto ditë dhe në veçanti ditën e Arafatit (ata që nuk janë në Haxh).

3. Të bëjmë sa më shumë lutje.

4. Të falim sa më shumë namaz nate.

5. Të lexojmë sa më shumë Kur'an.

6. Të largohemi nga gjynahet e haramet.

7. Të bëjmë sa më shumë vepra të mira.

Allahu na e mundësoftë që të bëjmë sa më shumë adhurime dhe punë të mira gjatë këtyre ditëve!

12. Letaif el-Mearif, f. 287.
13. Kur'ani, El-Maide: 3
14. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
15. Kur'ani, El-Keuther: 2.
16. Fethu'l-Bari, 2/460.

KURBANET, SAKRIFICË DHE SOLIDARITET NË FESTËN E KURBAN BAJRAMIT

Me rastin e festës së begatë të Kurban Bajramit 1444/2023, Myftinia Shkodër ka realizuar me sukses procesin e therjes dhe të shpërndarjes së kurbaneve, që iu besuan nga besimtarë të shumtë.

Gjatë ditëve të festës së madhe të Kurban Bajramit, janë therë dhe shpërndarë me dhjetëra kurbanë, prej bagëtive të imëta dhe të trasha, e me qindra paketa mishi, si dhuratë e kësaj feste të sakrificës dhe të solidaritetit, por edhe si ndihmë dhe përkrahje për njerëzit dhe familjet në nevojë.

Myftinia Shkodër falënderon të gjithë ata vëllezër dhe motra besimtarë, që sivjet ia besuan kurbanin e tyre institucionet të Myftinisë Shkodër me bindjen dhe lutjet tona, që Allahu i Madhërua t'ia pranojë secilit prej tyre, dhe me gatishmërinë e përhershme të këtij institucioni për të vazhduar rrugëtimin e pandalshëm për të përhapur vlerat e bamirësisë, solidaritetit dhe ndihmesës në mesin e njerëzve.

Gjithashtu, Myftinia Shkodër falënderon dhe shpreh mirënjohjen e

thellë për shoqatat partnere, "Helping Hand for Relief And Development", USA (HHRD), "Mirësia", etj, si dhe të gjithë ata vëllezër dhe motra besimtarë nga diaspora, të cilët na besuan këtë rit të kësaj feste të begatë, nga Amerika, Kanadaja, Zvicra, Gjermania, Franca, Belgjika, Italia, Anglia, Norvegjia, Mali i Zi, etj.

Myftinia Shkodër falënderon edhe imamët, të cilët gjatë këtyre ditëve të begata të kësaj feste të madhnueshme, u angazhuan maksimalisht në therjen dhe shpërndarjen e kurbaneve, dispozitë e rëndësishme e Kurban Bajramit.

Allahu ua pranoftë secilit prej tyre adhurimin dhe sakrificën e bërë!

KURBAN BAJRAMI,
FESTA MADHËSHTORE QË ZGJON SHKODRËN NË LUTJE!

Mëngjesin e sotëm, më 28 qershor 2023, në Shkodër mijëra besimtarë muslimanë kanë falur namazin e Kurban Bajramit në sheshin përbri xhamisë së madhe "Ebu Bekër", Fushë Celë.

Pjesë e programit ishin falja e namazit të sabahut, leximi i Kur'anit, ligjërata dhe mesazhe nga teologët Naim Drijaj, Lavdrim Hamja dhe Arben Halluni, falja e namazit të Kurban Bajramit dhe hytbeja e mbajtur nga teologu Idmir Plaku.

Në mesazhet e dhëna, u vu theksi tek ruajtja dhe forcimi i harmonisë në mesin e muslimanëve, bashkëpunimi përherë në rritje në tregti, biznes dhe në çdo fushë të jetës.

U theksua se kur muslimanët të arrijnë të dëshmohen si duhet në shoqëri, atëherë do të jemi dëshmitarë të mirësive, bereqetit dhe mirëqenies në rritje.

Hoxhallarët e nderuar bënë thirrje për paqtim me Zotin dhe distancim nga rrugët që shpien në haram dhe shthurje të individit dhe shoqërisë.

Nga ana tjetër, përfaqësues të kishave katolike dhe ortodokse Shkodër, drejtues të pushtetit vendor si; Kryetari i Bashkisë Shkodër, Benet Beci, Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Edona Bilali, Prefektja e Qarkut Shkodër, Majlinda Angoni, përfaqësues të partive politike, etj, gjatë pritjes së vizitave kanë përcjellë tek përfaqësuesit e Myftinisë Shkodër mesazhet e tyre të urimit me rastin e festës së Kurban Bajramit.

INGUSHETIA OSE REPUBLIKA E INGUSHETISË

Ingushetia, zyrtarisht Republika e Ingushetisë, është një nga republikat Ruse, e ndodhur në Kaukazin Verior të Euroazisë, dhe kufizohet me Çeçeninë në lindje, Gjeorgjinë në jug, dhe Osetinë e Veriut – Alania në perëndim dhe veriperëndim.

Ingushetia ka një sipërfaqe prej 3.600 km2 (republika me sipërfaqen më të vogël brenda Rusisë), dhe një popullsi prej 519.078 banorësh (viti 2022, sipas ceicdata.com).

Kryeqyteti i saj është qyteti Magas, ndërsa qyteti më i madh është Nazran.

GJEOGRAFIA

Relievi i territorit të Ingushetisë është i ngritur, i përbërë nga vargmale të ndara nga lugina dhe gryka. Rajoni i ultësirës veriore, që shkon e bashkohet me ekstremin jugor të stepës Nogaj, në disa vende është vetëm 200 metra mbi nivelin e detit, por pjesa më e madhe e Ingushetisë arrin në lartësinë të paktën 500 metra, me maja të shpërndara në rajonin jugor malor të Kaukazit, që ngrihen deri në 3.000 metra mbi nivelin e detit, edhe më lart. Nëpër territorin e republikës kalon një shtrirje prej 150 kilometrash e maleve të Kaukazit.

Lumenjtë kryesorë të vendit janë Sunzha, Assa, Fartanga, Armkhi. Lumi Sunzha, një degë e lumit Terek, përshkon zonën veriore të Ingushetisë, nga perëndimi në lindje. Assa, një degë e lumit Sunzha, është rrjedha kryesore në rajon.

KLIMA

Klima ndryshon në varësi të relievit, por në përgjithësi i përafrohet tipit të klimës së thatë kontinentale. Temperatura mesatare e Korrikut është +21 °C, kurse temperatura mesatare e janarit është 5 °C. Reshjet mesatare vjetore në vend shkojnë deri në 1200 mm në vit.

EKONOMIA

Në Ingusheti gjenden disa lloje burimesh kryesore natyrore, si: ujë mineral në Achaluki, naftë dhe gaz natyror në Malgobek, pyje në Dzheirakh dhe metale në Galashki.

Industria përpunuese e Ingushetisë përfshin produktet e naftës, produktet minerale jometale, përpunimin e metaleve dhe produktet metalike të gatshme, si dhe inxhinierinë e industrinë ushqimore.

Gjatë kërkimeve, në Ingusheti janë gjetur shtatë fusha nafte dhe gazi. Republika prodhon vaj të cilësisë së lartë. Nafta transportohet nga rajoni i Kaspikut drejt perëndimit nëpërmjet tubacionit kryesor Baku-Novorossiysk, që kalon përmes republikës.

Përveç sektorëve të industrisë, Ingushetia ka një sektor në zhvillim të materialeve të ndërtimit. Drurët e vlefshëm (lisi, ahu dhe shkoza) ofrojnë një industri në rritje të përpunimit të drurit.

Me lumenjtë e saj të shumtë, Ingushetia ka një potencial të madh hidroenergjetik.

Drejtimi kryesor i bujqësisë është blegtoria, mbarështimi i deleve dhe i dhive, dhe prodhimi i qumështit dhe i mishit. Drithërat (gruri, thekra dhe elbi), panxhari i sheqerit, luledielli, ushqimi për kafshë, perimet dhe patatet janë kulturat kryesore që prodhohen në vend. Kushtet janë gjithashtu të favorshme për prodhimin e frutave të ndryshme dhe rrushit.

GJUHA

Gjuha ingushe është gjuha kombëtare e folur nga ingushët, dhe i përket nëngrupit Nakh, të grupit të gjuhëve të Kaukazian Verilindor. Kjo gjuhë është shumë afër gjuhës çeçene. Të dyja gjuhët, ajo ingushe edhe çeçene, u pranuan si një gjuhë e vetme letrare deri në vitin 1934. Për shkak të arsimimit në medresetë muslimane, arabishtja dhe turqishtja shërbyen si gjuhë e lartë midis ingushëve dhe në fiset e tjera Kaukaziane. Ashtu si komunitetet e tjera myslimane, edhe ingushët përdorën alfabetin arab. Për të dalluar ingushët nga çeçenët, në vitin 1922 qeveria sovjetike u imponoi atyre alfabetin latin. Në vitin 1925 u shkrua gramatika ingushe, dhe ashtu si myslimanët e tjerë të përfshirë nën pushtetin sovjetik, në vitin 1938, gjuha e ingushëve kaloi në alfabetin cirilik (rus).

Gjuhët zyrtare në Ingusheti janë gjuha ingushe dhe ajo ruse.

FEJA

Popullsia e Ingushetisë është pothuajse 100% e besimit Islam, kryesisht ndjekës të shkollës Shafi dhe Hanefi, të Islamit sunit.

HISTORI

Emri Ingusheti, rrjedh nga fshati antik "Angusht" (i cili u riemërua Tarskoje dhe u transferua në Osetinë e Veriut në vitin 1944, pas dëbimit të 23 shkurtit 1944), dhe nga prapashtesa gjeorgjiane "éti", që do të thotë "vendi ku jetojnë ingushët". Populli i Ingushetisë veten e tyre e quajnë: GialgIaj, ose Galgai, që do të thotë "banorët e kullave".

Territori i Republikës së Ingushetisë ka qenë i banuar nga njerëzit që nga kohërat e lashta. Në Kaukazin e Veriut, në shekujt 7-4 p.e.s, u ngrit qytetërimi Koban. Vendbanimet e Kobanëve ndodheshin rrëzë kodrave të fortifikuara në mënyrë natyrale, ose përgjatë luginave të lumenjve në pllaja të larta dhe në kodra të veçuara. Në gjysmën e dytë të mijëvjeçarit të parë para erës sonë, fiset Koban krijuan një union të gjerë politik nën emrin Malkh. Ky union mbulonte territorin nga rajoni Elbrus dhe lumi Malka në perëndim, deri në rrëzë të vargmalit të Andean dhe tek ndërthurja e lumejve Sunzha dhe Argun, në lindje. Në lindje ky formacion shtetëror kufizohej me Albanianë Kaukaziane. Në veri, unioni Malkh përfshinte territorin e malësisë së Stavropolit, dhe në jug - pjesën e maleve të larta të Gjeorgjisë së sotme.

Në fillim të shekullit 2-të p.e.s., si rezultat i pushtimit ushtarak të Kaukazit të Veriut nga mbreti Seleucid Antioku i 3-të, uninoni politik Malkh u copëtua dhe u nda në fise, të njohura nga historia si Hamekitë, Sierbë, Dvalë, Sanarsë, Khonsë, Masakhë, Isadik, Gargarej, etj.

Nga fillimi i mijëvjeçarit të parë, era jonë, emri Alani i përfshinte të gjitha territoret që banoheshin fiset Ingushe të Kaukazit të Veriut, dhe në shekullin e 10-të, u formua shteti i Alanëve, me kryeqytetin Magas (Qyteti i Diellit). Në gjysmën e parë të shekullit 13-të, Shteti Alan u rrëzua si rezultat i pushtimeve mongole dhe hyri nën Hordhinë e Artë mongole. Në fund të shekullit 14-të, alanët u pushtuan nga Perandoria Timuride. Në gjysmën e dytë të shekullit 16-të, si rezultat i fushatës së princit Temriuk (dhjetor 1562), i mbështetur nga Nogai Murzas dhe Cari rus i 4-të, Ivani i Tmerrshëm, ingushët u detyruan të linin fushat dhe të arratisen në male, të cilët mundën të kthehen sërish nga fillimi i shekullit të 17-të.

Kryeqyteti, Magas

Në Mars të viti 1770, ingushët nënshkruajnë një marrëveshje me Rusinë për t'u bërë pjesë e Perandorisë Ruse. Në shekullin e 19-të, administrata ruse në Kaukaz nisi fushatën e dëbimit të ingushëve nga fshatrat që ndodheshin përgjatë lumenjve Fortanga, Assa, Sunzha, Kambileevka, duke i riemërtuar fshatrat e spastruara, dhe duke i populluar ato me kozakë (malësorë rusë). Një pjesë e ingushëve të këtyre fshatrave u internuan në Turqi, një pjesë vdiqën nga të ftohtit, uria dhe sëmundjet... dhe pjesa tjetër u vendosën në fshatrat të tjera Ingushe.

Në vitin 1860, me dekret të Perandorit Aleksandër i 2-të, u krijua rajoni Terek në pjesën lindore të Kaukazit të Veriut, i cili përfshinte rajonin e Çeçenisë, Ichkerian-isë, Ingushetisë dhe Nagornit. Si rezultat i një lufte të ashpër, në vitin 1905 ingushët arritën ndarjen e përkohshme të Ingushetisë nga rajoni Terek, dhe formimin e rajonit të pavarur Nazran, i cili në vitin 1909 u legalizua, e megjithatë, selia e autoriteteve gjendej në Vladikavkaz, dhe vazhdoi të luante një rol të madh në jetën e Ingushetisë.

Pamje nga kryeqyteti, Magas

Gjatë revolucionit të vitit 1917 dhe luftës civile, ingushët mbështetën në mënyrë aktive bolshevikët, duke besuar në premtimet e tyre për një zgjidhje të drejtë të çështjes kombëtare. Mijëra ingushë vdiqën në luftën për pushtetin sovjetik gjatë luftës civile. Me dekret të Komitetit Qendror Ekzekutiv të Përgjithshëm Rus, më 20 Janar të vitit 1921 u krijua Republika Socialiste Sovjetike Autonome Malore-Gorskaja RSSA. Me shpërbërjen e Gorskaya RSSA, Ingushetia u nda në një rajon autonom të veçantë, me qendër në qytetin e Vladikavkaz, i cili ekzistoi deri në Janar të vitit 1934, përpara se t'i bashkohej rajonit Çeçen-Ingush (i cili në Dhjetor 1936 u shndërrua në RSSA Çeçeno-Ingushe).

14

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, regjimi kriminal stalinist, me akuzën e pabazuar për bashkëpunim me pushtuesit nazistë (pavarësisht se gjatë gjithë luftës nuk u pushtua asnjë fshat i vetëm Ingush apo Çeçen), të gjithë ingushët dhe Çeçenët iu nënshtruan deportimit total në Kazakistan dhe Azinë Qendrore, dhe RSSA Çeçeno-Ingushe u asgjësua. Territori i Çeçeno-Ingushetisë u nda midis Republikave Socialiste Sovjetike Autonome të Osetisë së Veriut dhe Dagestanit, RSS-së së Gjeorgjisë dhe rajonit të Groznit, dhe shumica e tokave Ingushe u bënë pjesë e Osetisë së Veriut. Vetëm 13 vjet më vonë, ingushët dhe Çeçenët u lejuan të ktheheshin në atdheun e tyre.

Republika e Ingushetisë në kufijtë e sotëm është formuar më 4 Qershor të vitit 1992, por si pjesë e Federatës Ruse. Në shkurt të vitit 1993 u zgjodh presidenti i parë i Ingushetisë, Ruslan Aushev, u zgjodh parlamenti dhe u formua qeveria.

Megjithatë, gjurma ogurzezë e krimit të qeverisë sovjetike vazhdoi ta shoqërojë jetën e popullit Ingushetian. Në fund të Tetorit - fillimi i Nëntorit të vitit 1992, popullsia paqësore Ingushe e qytetit të Vladikavkaz dhe rrethit Prigorodny (e bashkëngjitur padrejtësisht Osetisë së Veriut në vitin 1957 pas shpërbërjes së RSSA Çeçeno-Ingushe), iu nënshtrua gjenocidit dhe spastrimit etnik. Ky veprim ishte i planifikuar paraprakisht. Kundër 65.000 civilëve ingushë të paarmatosur u angazhuan 68.000 luftëtarë të trajnuar mirë dhe të armatosur me teknologjinë më të fundit. Si rezultat, më shumë se 600 njerëz u vranë, 200 u zhdukën, kurse 65 mijë ingushë u kthyen në refugjatë.

SI ERDHI ISLAMI NË INGUSHETI

Islamizimi i popujve të Kaukazit të Veriut filloi me ardhjen e muslimanëve arabë atje në shekullin e 7-të. Në fakt, u deshën rreth 1000 vjet që Islami të përhapej në të gjithë rajonin. Në fazën e parë, Islami arriti në Dagestanin jugor dhe u përhap prej andej në perëndim të rajonit. Deri në shekullin e 15-të, në pjesën lindore të Kaukazit të Veriut Islami u përhap plotësisht. Megjithatë, u desh një kohë e gjatë (midis shekujve 17 dhe 19) që popujt myslimanë, të cilët jetojnë sot në rajon (veçanërisht popujt në perëndim të Kaukazit të Veriut) të hiqnin dorë nga besimet e tyre paraislamike. Islami, i cili arriti në Dagestan përmes thirrësve dhe luftëtarëve muslimanë arabë, u përhap në rajonet lindore të Kaukazit të Veriut nga thirrësit vendas, kurse në perëndim nga ndikimi i Perandorisë Osmane. Arsyeja pse shkolla Hanefi është e përhapur sot në perëndim të Kaukazit të Veriut, dhe shkolla Shafi në lindje, lidhet me këtë fenomen historik.

Në dokumentet historike përmendet se për herë të parë Islami depërtoi në Ingusheti në vitet 80-të, të shekullit të 16-të. Sipas historianëve, në shekullin e 18-të, kabardianët ndikuan fuqishëm në përhapjen e Islamit në rajonin e Ingushetisë. Shumica e ingushëve u konvertuan në Islam mes viteve 1809 - 1810.

Në vitet dhe shekujt e mëvonshëm, procesi i përhapjes së Islamit vazhdoi në mënyrë progresive, megjithëse duke hasur në kundërshtimin e autoriteteve. Në vitet 30-të shek. 19-të, pothuajse e gjithë popullsia e Ingushetisë ishte myslimane tashmë, dhe e tillë mbeti situata edhe pas përpjekjeve në dekadën e tretë të krishterizimit të dhunshëm të popullsisë ingushe.

Procesi i përqafimit të Islamit nga populli i Ingushetisë u zhvillua në disa faza dhe ishte kompleks, duke prekur të gjitha sferat e jetës. Kjo për shkak të një sërë rrethanash dhe si pasojë e përpjekjeve të vazhdueshme të autoriteteve për të imponuar fenë e krishterë tek popullsia ingushe. Një rol të rëndësishëm në përhapjen e Islamit atje luajti Kunta-Khaxhi Kishiev, i cili u shfaq në arenën politike dhe udhëhoqi një propagandë aktive të përhapjes së Islamit mes ingushëve. Kunta-Khaxhi Kishiev predikoi Islamin mes Ingushëve dhe Çeçenëve, me anë të fjalës dhe të një shkopi ku mbështetej kur ecte. Deshi Allahu që në Ingusheti besimi islam të zërë rrënjë në mënyrë paqësore. Të fundit që pranuan Islamin në Ingusheti ishin banorët e fshatit Gvileti, në vitin 1861.

Përgatiti:
Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

http://pravitelstvori.ru
http://wp.wiki-wiki.ru
https://medinaschool.org
https://www.britannica.com
http://council.gov.ru
https://ishr.org
https://www.insan-center.org
https://www.ceicdata.com
https://islamansiklopedisi.org.tr
https://www.insamer.com/tr

Pejgamberi (a.s) ka thënë:

Kur'ani është argument për ty, ose kundër teje. Çdo njeri zgjohet peng i vetes së tij, çlirues i saj, apo burgosës i saj (shkatërrues)!

(Transmetuar nga Muslimi)

DJEGIA E KUR'ANIT, ËSHTË AKT I SHËMTUAR DHE VEPRIM QË MBAN TË NDEZUR ZJARRIN E URREJTJES NË MESIN E POPUJVE!

MYFTIU I SHKODRËS, IMAM MUHAMED B. SYTARI DËNON AKTIN E SHËMTUAR PËR LEJIMIN E DJEGIES SË KUR'ANIT NË SUEDI

Në një postim të posatshëm nga Meka, ku ndodhet për kryerjen e Haxhit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari dënon aktin e shëmtuar të lejimit të autoriteteve suedeze për organizimin e një proteste për djegien e Kur'anit.

Në postimin e Myftiut shënohet sa vijon:

"Lejimi i autoriteteve të cilitdo vend në botë për djegien e Kur'anit, është akt i shëmtuar dhe veprim që mban të ndezur zjarrin e urrejtjes në mesin e popujve!

Është e neveritshme, e dënoj me zemër, siç dënoj çdo tentativë të kujtdo qoftë, tek ne dhe përtej, që me djallëzira përpiqet të prekë shenjtërinë e festave tona islame!

"Ai (All-llahu) është që e dërgoi të dërguarin e vet me udhëzim të qartë e fé të vërtetë, për ta bërë mbizotërues mbi të gjitha fetë, edhe pse idhujtarët e urrejnë." – (Kur'ani, Es-Saf: 9)"

Myftinia e Shkodrës dënon çdo përpjekje për denigrimin e shenjtërive dhe lutet, që gjeste dhe veprime të tilla primitive të mos përsëriten në mesin e racës njerëzore.

OBI DO TË MBAJË TAKIM TË JASHTËZAKONSHËM PËR MASAT KUNDËR SULMIT NDAJ KURANIT

Organizata e Bashkëpunimit Islam (OBI) më 2 korrik do të mbajë takim të jashtëzakonshëm në qytetin Jeddah të Arabisë Saudite për të diskutuar djegien e Kuranit në Suedi, raporton Anadolu.

Sipas informacioneve të siguruara nga burimet diplomatike, në takimin e OBI-t të planifikuar më 2 korrik do të diskutohen masat kundër sulmit ndaj Kuranit të kryer më 28 qershor në kryeqytetin e Suedisë, Stockholm.

Takimi i jashtëzakonshëm i Komitetit Ekzekutiv me pjesëmarrje të hapur në të cilin mund të marrin pjesë përfaqësuesit e përhershëm të të gjitha vendeve anëtare të OBI-t, si dhe vendet anëtare të Komitetit ekzekutiv të OBI-t në të cilin përshihen Türkiye, Arabia Saudite, Gambia, Pakistani, Mauritania dhe Kameruni, do të mbahet me kërkesë të Arabisë Saudite, e cila ka presidencën e radhës të Samitit të OBI-t.

Në takim synohet të diskutohen masat që do të merren kundër veprimeve të tilla dhe do të paraqitet qëndrim i përbashkët kundër mosrespektimit të Kuranit.

BE: DJEGIA E KURANIT APO ÇDO LIBRI TJETËR TË SHENJTË ËSHTË 'AKT I QARTË PROVOKIMI'

Nabila Massrali

Bashkimi Evropian tha sot se djegia e kopjes së Kuranit ose çdo libri tjetër të shenjtë "është fyese dhe mosrespektuese dhe akt i qartë provokimi".

Deklarata e bllokut erdhi pasi një person i identifikuar si Salwan Momika dogji një kopje të librit të shenjtë musliman nën mbrojtjen e policisë përpara një xhamie në Stokholm të mërkurën.

Provokimi ndodhi në ditën e Kurban Bajramit, një nga festat kryesore fetare islame të festuar nga muslimanët në mbarë botën.

"Manifestimet e racizmit, ksenofobisë dhe intolerancës që buron nga këto nuk kanë vend në Evropë", tha në një deklaratë Nabila Massrali, zëdhënësja e BE-së për politikën e jashtme dhe sigurinë.

"BE-ja i bashkohet Ministrisë suedeze të Punëve të Jashtme në refuzimin e saj të fuqishëm të djegies së Kuranit nga një individ në Suedi. Ky akt në asnjë mënyrë nuk pasqyron opinionet e Bashkimit Evropian", theksoi Massrali.

"Është edhe më e trishtueshme që një akt i tillë është kryer në festën e rëndësishme muslimane të Kurban Bajramit", shtoi ajo. /atsh

Herët a vonë, do tua mësojmë kokave të arrogancës perëndimore, se fyerja e shenjtërive të muslimanëve nuk është liri mendimi.

Ne do të reagojmë në mënyrën më të fortë të mundshme!

Rexhep Tajip Erdogan
Presidenti i Turkijes

SHEFI I DIPLOMACISË TURKE DËNON DJEGIEN E KUR'ANIT NË SUEDI

Ministri turk i Punëve të Jashtme, Hakan Fidan, ka dënuar djegien e librit të shenjtë Kur'anit në Suedi në ditën e parë të festës së madhe muslimane të Kurban Bajramit, transmeton Anadolu Agjensi (AA).

Dënoj veprimin e poshtër në Suedi kundër librit tonë të shenjtë, Kur'anit, në ditën e parë të Kurban Bajramit. Është e papranueshme të lejohen këto veprime islamofobike anti-muslimane nën pretekstin e lirisë së shprehjes.

Të mbyllësh sytë ndaj akteve të tilla mizore do të thotë të jesh partner në krim!

U ZHVILLUA TAKIMI PERIODIK I IMAMËVE DHE MUEZINËVE TË SHKODRËS

Paraditën e së mërkurës, më 7/6/2023, u zhvillua takimi periodik i radhës i imamëve dhe muezinëve të Myftinisë Shkodër.

Në krye të herës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, iu drejtua të pranishmëve me fjalën e rastit, ku dha edhe udhëzimet e duhura për periudhën aktuale dhe vazhdimësinë e aktivitetit të Thirrjes Islame në krejt hartën e vendit.

Në prag të nisjes së haxhilerëve drejt vendeve të shenjta, u dha udhëzim që dy hytbet e ardhme, ato të datave 9 dhe 16 qershor 2023, në të gjitha xhamitë e Shkodrës, t'i kushtohen vlerave dhe mesazheve të Haxhit.

U diskutua për disa çështje me rëndësi, që prekin thelbin e angazhimit të secilit dhe rritjes së profesionalizmit dhe përgjegjësisë në drejtim të gjallërimit të jetës fetare, ruajtjes së traditave dhe ekuilibrit në komunitet.

Myftiu dëgjoi edhe mendimet dhe sugjerimet e disa prej imamëve, me ç'rast u vendos që takimi i ardhshëm të zhvillohet në xhaminë e kalasë së Drishtit.

NIS TRAJNIMI I HAXHILERËVE SHKODRANË PËR VITIN 1444/2023

Paraditën e së hënës, më 12/6/2023, në ambientet e xhamisë së Parrucës, Myftinia Shkodër, nisi trajnimin e përvitshëm të haxhilerëve të Shkodrës, me qëllim përgatitjen emocionale dhe shpjegimin e detajeve të duhura për kryerjen me sukses të Haxhit dhe ritualeve të tij.

Në ligjëratën e parë të mbajtur ditën e sotme, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, trajtoi vlerën dhe madhështinë e Haxhit, nëpërmjet haditheve të Pejgamberit (a.s).

Ndërkohë, në ligjëratën e dytë të kësaj dite, imami i xhamisë së Fushë Çelës, H. Idmir Plaku, shpjegoi detaje me rëndësi rreth shenjtërisë së Mekës dhe Medines së Ndriçuar, si dhe disa stacioneve të spikatura në adhurimet e ditëve të Haxhit në këto dy qytete të begata.

Trajnimi i haxhilerëve do të vijojë me ligjëratat e dy ditëve në vijim, shpjegimin e detajeve të ritualeve të këtij adhurimi të spikatur, mësimin e disa lutjeve dhe dhikreve, etj.

Për nder të haxhilerëve shkodranë, ditën e enjte, më 15/6/2023, në ora: 19.00, në oborrin e xhamisë së Parrucës do të zhvillohet një program i pasur festiv.

CEREMONI MADHËSHTORE PËR NDER TË HAXHILERËVE SHKODRANË!

Në një atmosferë të begatë besimi, vëllazërie dhe qytetarie, besimtarë të shumtë morën pjesë pasditën e së enjtes, më 15/6/2023, në ceremoninë festive, në përmbyllje të aktiviteteve dhe ligjëratave, për nder të 110 haxhilerëve shkodranë, që këtë vit do të marrin pjesë në kryerjen e ritualeve të adhurimit që mbledh miliona besimtarë muslimanë nga mbarë bota.

Ceremonia nisi me leximin e një pjese kur'anore të kënduar nga lexuesi me famë botërore, Shejkh Muhammed Siddik El-Minshavi, shfaqur në ekranin e madh në sheshin e xhamisë së Parrucës.

Aktiviteti u pasua nga fjala e rastit, mbajtur me plot emocione nga teologu Arben Halluni, që nuk i fshehu lotët, në urimet dhe lutjet drejtuar haxhilerëve të Shkodrës.

Më pas, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, iu drejtua të pranishmëve me një fjalë, në të cilën ishin përmbledhur shumë mesazhe që lidhen me të sotmen e muslimanëve në vendin tonë dhe simbolikat e Haxhit.

Pjesë e kësaj ceremonie ishte edhe shfaqja e dokumentarit rreth vlerave të Ujit Zemzem, përkthyer në shqip dhe titruar nga teologu Lavdrim Hamja.

Më pas u shfaqën fotografitë e vjetra të arkivit të Myftinisë Shkodër, dhuruar para pak ditësh nga prof. Muamer Vuci, foto në të cilat dëshmohet qartë përcjellja e haxhilerëve shkodranë të fillim shekullit 20.

Një program i bukur artistik, përgatitur nga nxënësit e xhamisë Bardhaj dhe imami Ilir Dizdari, ia shtuan bukurinë dhe emocionet kësaj mbrëmjeje festive në zemër të Shkodrës.

Poashtu, këndimi i ilahisë së Bajramit nga këngëtarja e talentuar Ea Zoga, e zbukuroi edhe më shumë këtë ceremoni.

Momenti më kulminant ishte thirrja e emrave të haxhilerëve të dashur dhe dorëzimi i pasaportave me vizën e haxhit dhe ihramin për burrat.

Të pranishmit u njohën edhe me dy udhëheqësit e grupit të haxhive shkodranë, imamët e nderuar, Altin Nikshiqi dhe Ilir Dizdari, që do të shoqërojnë 110 haxhilerët e Shkodrës, bashkë me pjesën tjetër të haxhilerëve shqiptarë të këtij viti, nën drejtimin e udhëheqësve të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Myftinia Shkodër falënderon krejt pjestarët e stafit dhe të gjithë ata që ndihmuan për realizimin e këtij aktiviteti madhështor, si dhe uron rrugë të mbarë dhe haxh të pranuar për haxhilerët e vet!

U ZHVILLUA KONKURSI I MADH FETAR, EDICIONI I 11-TË ME NXËNËSIT E MEJTEPEVE TË XHAMIVE TË ZONAVE ADMINISTRATIVE OBLIKË DHE BËRDICË

Ditën e shtunë paradite, më 17 qershor 2023, në Qendrën Kulturore të xhamisë Oblikë, Myftinia Shkodër përmes sektorit të arsimit organizoi aktivitetin e konkursit të madh të 11-të me nxënësit e mejtepeve/kurseve fetare të xhamive të zonave administrative Oblikë dhe Bërdicë

Ky aktivitet, që mblodhi nxënësit konkurrues të 11 xhamive: Oblikë, Muriqan, Alimetaj, Velinaj, Xhaferraj, Zusë, Bërdicë e Sipërme, Bërdicë e Mesme,Trush, Shirq dhe Rrushkull së bashku me nxënësit e tjerë të këtyre kurseve, u hap me fjalën e drejtuesit të arsimit, teologut Arben Halluni, i cili pasi i uroj mirëseardhjen nxënësve frekuentues sistematikë në mejtepet e xhamive, u foli për rëndësinë e këtij aktiviteti, i cili frymëzon besim, adhurim, edukatë, kulturë, respekt, vëllazëri dhe harmoni me të gjithë.

Aktiviteti i konkursit të madh fetar u shoqërua me veprimtari sportive e zbavitëse si dhe lojëra animatore në ambientet e jashtme të xhamisë Oblikë

Në fund u zhvillua ceremonia e shpalljes së fituesve, ku juria e përbërë nga H. Naim Drijaj dhe H. Lavdrim Hamja dhe hafizi Bajram Hoxha nga Turkia, në bazë të pikëve maksimale vendosën:

– Në konkursin e Kur'anit, Xhuzi Amme: Çmimi i parë, nxënësit të xhamisë Trush, Erald Tula.

– Në konkursin e Leximit/Mësimit të Kur'anit dhe Ilmihal: Çmimi i parë, nxënëses së xhamisë Zusë, Dhurata Mehja; çmimi i dytë, nxënësit të xhamisë Oblikë, Elsaid Plori dhe çmimi i tretë, nxënësit të xhamisë Shirq, Briken Beqiri.

– Në konkursin e këndimit të bukur të Ezanit: Çmimi i parë, nxënësit të xhamisë Rrushkull, Orgest Beqiri.

Në ditët në vijim, olimpiada e Konkursit të Madh Fetar do të organizohet edhe në zona të tjera të xhamive të Shkodrës.

110 HAXHILERË NGA SHKODRA U NISËN PËR TË KRYER HAXHIN E SIVJETSHËM...

Mëngjesin e sotëm, e martë, më 20 qershor 2023, nga oborri i xhamisë së Parrucës u bë përcjellja e haxhilerëve shkodranë të këtij viti për në vendet e Shenjta, në Mekë dhe Medinë, të cilët do të bashkohen në Mekë me grupin e haxhilerëve të tjerë shqiptarë, e më pas të gjithë së bashku do të vazhdojnë ritet përkatëse për të kryer kushtin e pestë të fesë islame, obligimin e Haxhit.

Grupi i haxhilerëve të sivjetshëm shkodranë përbëhet nga 110 persona, burra e gra, të cilët u përcollën nga familjarët e tyre, të afërm, nga besimtarë të shumtë si dhe nga përfaqësues të Myftinisë Shkodër.

Në këtë atmosferë vëllazërore, në mesin e besimtarëve të shumtë, familjarëve dhe të afërme, të cilët kishin dalë për të përcjellë e për të përshëndetur vëllezërit dhe motrat e tyre haxhilerë, u bë nisja për në vendin më të mirë dhe më të bekuar të botës, Meka e bekuar dhe Medineja e Ndriçuar.

Në mesazhin e tij, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, u shpreh: "Përherë them, se emocioni i përcjelljes së haxhilerëve është më i bukuri i krejt emocioneve dhe aktiviteteve të shumta, që ne kemi gjatë vitit. Përcjellja e haxhilerëve, siç e shihni, krijon një atmosferë jashtëzakonisht të begatë, ku njerëz të shumtë, të ardhur nga zona të ndryshme të qytetit, janë mbledhur para xhamisë së Parrucës dhe me emocionet e tyre e me përshpirtjet e tyre i urojnë rrugë të mbarë haxhilerëve.

Ata shkojnë drejt vendeve të bekuara, për të adhuruar Zotin e tyre, për të lartësuar mesazhet dhe thirrjet e zemrës, aty përpara Qabes së Madhërueshme, nesër te Pejgamberi (a.s); si të thuash, në një mënyrë a në një tjetër, bashkohen të gjitha elementet dhe detajet më të bukura, të fesë dhe fetarizmit, dhe shkrihen në këtë moment dhe në këtë ceremoni madhështore, ku njerëzit nga anë e mbanë botës, bashkohen me rroba të bardha për të madhëruar Zotin Një.

Natyrshëm, si ceremonia e përcjelljes së haxhilerëve, si tubimi i tyre në vendin e shenjtë, është patjetër një gjallërim i madh për zemrat tona dhe për vetëdijen tonë islame, është simbol i unitetit dhe i harmonisë në mesin e muslimanëve.

Numri i madh i haxhilerëve të këtij viti, nuk është asgjë tjetër, veçse thirrja e shpirtit, thirrja e zemrës dhe besimi në zemrat e muslimanëve të këtij vendi, që përtej shtypjes, përtej presionit, përtej pengesave, përtej vështirësive edhe ekonomike, e gjejnë aty kënaqësinë e adhurimit dhe gjejnë forcën për ta dëshmuar përkatësinë e tyre dhe identitetin e tyre islam, edhe nëpërmjet kryerjes së këtij rituali shumë të rëndësishëm, edhe shumë të shtrenjtë, por që besimi është më i shtrenjtë se çdo pasuri tjetër në jetë.

Mesazhi më i mirë, sidomos sot, në mesin e këtyre besimtarëve është, që njerëzit ta ruajnë tabanin e tyre, mos të devijojnë nga tabani i tyre për asnjë arsye në botë! Mesazhi më i mirë sot është me kuptuar, se ky Islam, edhe kjo dritë nuk shuhen asnjëherë përtej çdo përpjekjeje dhe përtej çdo agjenteje, dhe se kjo është feja e Allahut, e feja e Allahut do të ecë përpara, me apo pa dëshirën tonë, me apo pa përkrahjen tonë, dhe i lumi ai, pastaj i lumi ai, që kapet fort pas tabanit të të parëve, e ruan shpirtin e baballarëve dhe gjyshërve, e trashëgon atë dhe ia mëkon edhe fëmijëve të tij, dhe ecë përpara me këtë dritë, për të parë se e sotmja dhe e ardhmja, me këtë dritë, janë bekim nga Zoti dhe përgjegjësi për të përhapur dritën e Tij, kudo që jemi dhe me këdo që jemi!"

Myftinia Shkodër uron: Haxh dhe lutje të pranuara për të gjithë haxhilerët, shkodranë, shqiptarë dhe të mbarë botës islame!

U ZHVILLUA EDICIONI I 11-TË I KONKURSIT TË MADH FETAR ME NXËNËSIT E MEJTEPEVE TË ZONAVE ADMINISTRATIVE BUSHAT DHE GUR I ZI

Ditën e enjte paradite, më 22 qershor 2023, në Qendrën Kulturore të xhamisë Barbullush, Myftinia Shkodër përmes sektorit të arsimit organizoi aktivitetin e edicionit të 11-të të konkursit të madh fetar me nxënësit e mejtepeve/kurseve fetare të xhamive të zonave administrative Bushat dhe Gur i Zi.

Aktiviteti që mblodhi nxënësit konkurrues të 10 xhamive: Barbullush, Bushat, Krye-Bushat, Shkjezë, Gur i Zi, Rragam, Kuç, Vukatanë, Mjedë, Ganjollë, së bashku edhe me nxënësit e tjerë si pjesëmarrës, filloi me fjalën e drejtuesit të arsimit, teologut Arben Halluni, i cili pasi i uroi mirëseardhjen nxënësve frekuentues sistematikë në mejtepet e xhamive, u foli për rëndësinë e këtij aktiviteti, që ka për qëllim të nxisë moshat e reja drejt mësimit të Kur'anit, njohurive bazë të besimit si dhe të ofrojë dhe bashkojë nxënësit në shtëpitë e Zotit, si vendet më të sigurta dhe garantuese për një shoqëri besimtare, të moralshme dhe të paqtë me të gjithë.

Aktiviteti i konkursit të madh fetar u shoqërua me veprimtari sportive e zbavitëse si dhe lojëra animatore në ambientet e jashtme të xhamisë Barbullush.

Pas përfundimit të konkurrimit, u zhvillua ceremonia e shpalljes së fituesve, ku juria e përbërë nga H. Naim Drijaj dhe H. Lavdrim Hamja dhe hafizi Bajram Hoxha nga Turkia, në bazë të pikëve të marra nga secili nxënës konkurrues, vendosën:

– Në konkursin e Kur'anit, xhuzi Amme: Çmimi i parë iu dha nxënësit të xhamisë Ganjollë, Erigers Tahiri.

– Në konkursin e Leximit të Kur'anit dhe Ilmihal: Çmimi i parë iu dha nxënëses së xhamisë Mjedë, Albana Bylbyli, çmimi i dytë, nxënëses të xhamisë Barbullush, Rejana Molla dhe çmimi i tretë, nxënësit të xhamisë Bushat, Nihad Pervizi.

– Në konkursin e këndimit më të bukur të ezanit: Çmimi i parë iu dha nxënësit të xhamisë Bushat, Elsaid Abazi.

Në ditët në vijim, olimpiada e Konkursit të Madh Fetar do të organizohet edhe me zona të tjera të xhamive të Shkodrës.

NXËNËSIT E MEJTEPIT FETAR NË XHAMINË MES-MYSELIM FESTOJNË KURBAN BAJRAMIN

Në kuadër të festës së Kurban Bajramit, nxënësit e mejtepit/kursit fetar të xhamisë Mes-Myselim, të Njësisë Administrative Postribë, Shkodër festuan Kurban Bajramin.

Përmes veprimtarive argëtuese, zbavitëse dhe sportive ata manifestuan gëzimin dhe harenë e kësaj feste, e cila bashkoi edhe prindërit e tyre, të cilët ishin vetë ata që kontribuuan me dhurata simbolike për nxënësit e mejtepit, të cilët marrin në mënyrë të vazhdueshme mësime fetare dhe edukative sipas programit të Myftinisë Shkodër.

Në fund fëmijët, me pjesëmarrjen edhe të mësuesit të tyre, Fatmir Sula shijuan disa gatime dhe ëmbëlsira të përgatitura enkas për festën e Kurban Bajramit.



KOMUNITETI MUSLIMAN I SHQIPËRISË - MYFTINIA SHKODËR

MYFTINIA SHKODËR

HAXH TË PRANUAR haxhilerëve të Shkodrës, të Shqipërisë dhe të mbarë ymetit islam!

Pejgamberi (a.s) ka thënë: "HAXHI I PRANUAR nuk ka shpërblim tjetër, VEÇSE XHENETIN!"

(Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi)

ME ZEMËR TË MIRË KURBAN BAJRAMIN!

E MËRKURË, 28 QERSHOR 2023 | BAJRAMI FALET NË ORËN: 6.00

www.myftinia-shkoder.org

@Myftiniashkoder1990

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek